



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit
Komisioni për Integritet Evropian
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Nga: Komisioni për Buxhet dhe Financa

Lënda: Raport me Amendamente për Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256

Datë: 24.4.2019

Në bazë të neneve 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2019, shqyrtoi Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Dardan Molliqaj, deputeti Lutfi Zharku dhe deputetët Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, dhe raportin me amendamente e procedon në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës:

R a p o r t

me amendamente për Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256

Amendamenti 1

Neni 2.2, në paragrafin 1.14. të shtuar në ligjin bazik, fshihet teksti “të cilët janë përgjegjës për shkeljen e ligjit”.

Amendamenti 2 – Dy Propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.3, fshihet paragrafi 2/A i shtuar i ligjit bazik.

B). Deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4, paragrafi 2 i ligjit bazik, paragrafi i shtuar 2/A (neni 2, paragrafi 3 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

2/A. Fjala “monetare” zëvendësohet me “jo monetare”.

Amendamenti 3, dy propozime:

A). Komisionit FunkSIONAL

Neni 2., fshihet paragrafi 3, përfshirë edhe paragrafi 2/B të shtuar i ligjit bazik.

B). Deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4, paragrafi 2 i ligjit bazik, paragrafi i shtuar 2/B (neni 2 paragrafi 3 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

2/B. Fjala “qëllimit të” zëvendësohet me “dhënies së”

Amendamenti 4, deputetit Lutfi Zharku, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 4, i ligjit bazik, paragrafi i shtuar 6 (neni 2, paragrafi 4 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

6. Fshihet fjala “rreptësishtë” dhe shuma “50 eurosh” zëvendësohet me shumën “500 (pesëqind) euro.”

Amendamenti 5

Neni 2.5, teksti referues: “Te neni 5 i ligjit bazik, ndryshohen pikat 1.1 dhe 1.2 të paragrafit 1 dhe pas paragrafit 4, i shtohet paragrafi i ri 5, me tekstin si vijon:”

ndryshohet me tekstin referues:

“Neni 5 i ligjit bazik, në paragrafin 1, ndryshohen nënparagrafët 1.1. dhe 1.2. dhe shtohet nën-paragrafi i ri 1.3., si dhe pas paragrafit 4, shtohet paragrafi i ri 5, me tekstin si vijon:”

Amendamenti 6

Neni 2.5, pas nënparagrafit 1.2., shtohet nënparagrafi i ri 1.3., me tekstin si vijon:

1.3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1, nënparagrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, pas shpalljes së zgjedhjeve, personat fizik mund të japin kontribute, jo më shumë se 4000 (katër mijë) euro dhe personat juridik jo më shumë se 20 000 (njëzetë mijë) euro.

Amendamenti 7, deputetit Lutfi Zharku , me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 5, i ligjit bazik, paragrafi i shtuar 5 (neni 2, paragrafi 5 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

Fshihen fjalët “rreptësishtë” dhe “emrin e pronarit”.

Amendamenti 8, deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 9, paragrafi 1 i ligjit bazik, fjalia e shtuar te paragrafi 2 i ligjit bazik (neni 2 paragrafi 6 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

1. Shtohen fjalët “vetëm pasi që KQZ pranon kërkesën apo pëlqimin me shkrim të bartësit (udhëheqësit) të koalicionit”.

Amendamenti 9 , dy propozime:

A). Deputetit Lutfi Zharku – Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 9, paragrafi 1 i ligjit bazik, fjalia e shtuar te paragrafi 2 i ligjit bazik (neni 2, paragrafi 6 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

2. Fshihet në tërësi paragrafi 2.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci – Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 2, paragrafi 6.2, të fshihet në tërësi.

Amendamenti 10

Neni 2, paragrafi 7, fshihet.

Amendamenti 11

Neni 2, paragrafi 9, fshihet.

Amendamenti 12

Neni 2, paragrafi 10, referenca “nënparagrafi i ri 3.6.”, ndryshohet me referencën “nënparagrafi i ri 3.5.”

Amendamenti 13

Neni 2.11, paragrafi 1 i nenit 19 i riformuluar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

1. Raportet Vjetore Financiare, si dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, nga auditorë të cilët do t’i përzgjedhë KQZ nëpërmjet një konkursi të hapur publik për aplikim. Procesi i auditimit i nënshtrohet rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Amendamenti 14

Neni 2.11, paragrafi 2 i nenit 19 i riformuluar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

2. KQZ, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, i përzgjedh me konkurs të hapur publik së paku 10 (dhjetë) auditorë të licencuar, qoftë si person fizik apo person juridik, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare, si dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës të subjekteve politike, të cilët ndërmarrin veprimet në emër të KQZ-së. Për t’u përzgjedhur auditorët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

Amendamenti 15

Neni 2.11, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3. i nenit 19 i riformuluara të ligjit bazik, në fund të fjalisë, teksti 3 (tre) bëhet 5 (pesë).

Amendamenti 16

Neni 2.11, Paragrafi 2, nënparagrafi 2.5. i nenit 19 i riformuluara i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

2.5. të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale.

Amendamenti 17

Neni 2.11, paragrafi 3 i nenit 19 i riformuluara i ligjit bazik, fshihet në tërësi.

Amendamenti 18

Neni 2.11, paragrafi 4 i nenit 19 i riformuluara i ligjit bazik, në rreshtin e tretë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ”. Po ashtu në këtë paragraf, fshihet teksti “Zyra do të sigurojë që të ketë së paku 3 (tre) auditorë në listë rezervë”.

Amendamenti 19

Neni 2.11, në paragrafët 5 dhe 6 të nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ-ja”.

Amendamenti 20, dy propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.11, paragrafi 7 i nenit 19 i riformuluara i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

7. Subjektet politike me kërkesën e auditorit i ofrojnë të gjitha dokumentet e kërkuara menjëherë dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

B) Deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 4.7 i ligjit bazik (neni 2 paragrafi 11 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

7. Numri “5” zëvendësohet me “15”.

Amendamenti 21

Neni 2.11, në paragrafin 8 të nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, në rreshtin e tretë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ”. Po ashtu në rreshtin gjashtë të këtij paragrafi, fshihet teksti “sipas rekomandimeve të Zyrës”.

Amendamenti 22

Neni 2.11, në paragrafin 9 të nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, në rreshtin e parë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ-ja”. Po ashtu në rreshtin e tretë dhe katërt të këtij paragrafi, fshihet teksti “organit më të lartë ekzekutiv”.

Amendamenti 23

Neni 2.11, në paragrafin 14 të nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, në rreshtin e pestë, fjala “Zyrës”, zëvendësohet me fjalën “KQZ-së”.

Amendamenti 24

Neni 2.11, në paragrafin 16 të nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, në rreshtin e parë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ-ja”. Po ashtu në rreshtin e dytë, teksti “uebsajtin zyrtar”, ndryshohet me tekstin “ueb faqen zyrtare”.

Amendamenti 25, deputetit Lutfi Zharku, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 16 i ligjit bazik (neni 2, paragrafi 11 i projektligjit) ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

16. Fjalët “mbajtjes së zgjedhjeve raportin”, zëvendësohen me fjalët “pranimin të raportit”

Amendamenti 26

Neni 2.11, në paragrafin 17 të nenit 19 të riformuluar të ligjit bazik, në rreshtin e parë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ-ja”.

Amendamenti 27

Neni 2.11, paragrafi 18 i nenit 19 të riformuluara të ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

18. KQZ-ja përgatit raportin vjetor për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi, duke përfshirë të gjeturat e dala nga procesi i auditimit dhe rekomandimet që KQZ-ja nxjerr me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mekanizmave për financimin e partive politike, sidomos në aspekt të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Ky raport i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, jo më vonë se data 31 korrik të çdo viti.

Amendamenti 28, dy propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. i nenit 19/A i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

1.2. Raportet periodike dhe vjetore të shpenzimeve t’i bëjë publike në ueb faqen zyrtare brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi në KQZ;

B). Deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Pas nenit 19 të ligjit bazik, shtohet neni 19/A, paragrafi 1.2 (neni 2, paragrafi 11 i projektligjit) të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

1.2 Fshihet në tërësi.

Amendamenti 29, dy propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. i nenit 19/A i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

1.3. Të dorëzojë pranë KQZ-së çdo 3 (tre) muaj, listën e kontribuuesve që përfshinë emrin dhe mbiemrin, në rast të personit fizik apo emërtimin e personit juridik, si dhe llojin, shumën dhe datën e kontributit;

B). Deputetit Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Pas nenit 19 të ligjit bazik, shtohet neni 19/A, paragrafi 1.3 (neni 2, paragrafi 11 i projektligjit) të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

1.3 Fshihen fjalët “ose në rast të fushatës se paku çdo 2 (dy) javë”.

Amendamenti 30

Neni 2.11, në paragrafin 2 të nenit 19/A të shtuar të ligjit bazik, në rreshtin e tretë, fjala “Zyrës” , zëvendësohet me fjalën “KQZ-së”. Si dhe në rreshtin e fundit, fjala “Zyra”, zëvendësohet me fjalën “KQZ”.

Amendamenti 31

Neni 2.11, në paragrafin 3 të nenit 19/A të shtuar të ligjit bazik, në rreshtin e gjashtë, fshihet fjala “në Zyrë”.

Amendamenti 32

Neni 2.12., në paragrafin 1 të nenit 21 të ndryshuar i ligjit bazik, në rreshtin e parë, fjala “Zyra” , zëvendësohet me fjalën “KQZ-ja”.

Amendamenti 33

Neni 2.12., paragrafi 2 i nenit 21 i ndryshuar i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

2. Mjetet e KQZ-së të mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 34, dy propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.12., paragrafi 4 i nenit 21 i ndryshuar i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

4. Subjekti Politik i sanksionuar apo ndaj të cilit është shqyrtuar gjoba mund të apelojë kundër vendimit të KQZ-së për shqiptimin e gjobës ose të sanksionit tjetër pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas pranimit të vendimit nga KQZ-ja, dhe në gjykatën kompetente të shkallës së dytë brenda 8 (tetë) ditëve, pas pranimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 21, paragrafi 4, të riformulohet si vijon:

4. Subjekti i sanksionit mund të apelojë kundër vendimit për shqiptimin e gjobës ose të sanksionit tjetër pranë PZAP-së si shkallë e parë dhe në gjykatën supreme si shkallë e dytë brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas njoftimit për vendimin.

Amendamenti 35

Neni 2.12., paragrafi 5 i nenit 21 i ndryshuar i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

5. Subjekti Politik i sanksionuar apo ndaj të cilit është shqyrtuar gjoba e parashtron në KQZ një kopje të fletëpagesës së gjobës që e ka paguar.

Amendamenti 36

Neni 2.12., në paragrafin 6 të nenit 21 të ndryshuar i ligjit bazik, teksti ” 4,000 (katërmijë) euro deri në 40,000 (dyzetmijë)” euro, ndryshohen me tekstin ”1000 (njëmijë) deri në 10,000 (dhjetëmijë) euro”.

Amendamenti 37

Neni 2.12., në paragrafët 6.4, 6.5. dhe 6.6 të nenit 21 të shtuar të ligjit bazik, fjala “Zyrë” , zëvendësohet me fjalën “KQZ”.

Amendamenti 38

Neni 2.12., në paragrafin 6.7 të nenit 21 të shtuar të ligjit bazik, fjala “nëpër” , zëvendësohet me fjalën “në”. Po ashtu, fjala “librat (evidencat)”, riformulohet teknikisht “librat, evidencat”

Amendamenti 39, dy propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.12., paragrafi 7 i nenit 21 të ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

7. KQZ-ja duhet t’ia lëshojë masën paralajmëruese subjektit politik në rastin kur e identifikon gjatë procedurave të përputhshmërisë se mangësia mund të korrigjohet. Afati i fundit për ta përmbushur paralajmërimin dhe bërë korrigjimin është 5 (pesë) ditë nga data e lëshimit të paralajmërimit.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 21, paragrafi 7, të riformulohet si vijon:

7. Zyra duhet t’ia lëshojë masën paralajmëruese subjektit politik në rastin kur e identifikon gjatë procedurave të përputhshmërisë se mangësia mund të korrigjohet. Afati i fundit për ta përmbushur paralajmërimin dhe bërë korrigjimin është 5 (pesë) ditë nga data e lëshimit të paralajmërimit.

Amendamenti 40

Neni 2.12., paragrafi 8 i nenit 21 i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

8. Nëse një subjekt politik ka bërë ndonjërin prej shkeljeve të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni, gjobat nga 1,000 (njëmijë) euro deri në 2,000 (dymijë) euro u shqiptohen personave përgjegjës të subjektit politik në fjalë, nëse vërtetohet se shkelja ka ndodhur për shkak të veprimit ose mosveprimit të tyre.

Amendamenti 41

Neni 2.12., paragrafi 9 i nenit 21 i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

9. Kandidatët për kryetarë të komunave dhe kandidatët e pavarur dënohen me gjobë prej 1,000 (njëmijë) euro deri në 2,000 (dymijë) euro për shkelje të përcaktuara me paragrafin 6 të këtij neni.

Amendamenti 42

Neni 2.11., në paragrafin 11 të nenit 21 shtuar të ligjit bazik, teksti “5,000 (pesëmijë) euro deri në 15,000 (pesëmbëdhjetë) euro”, ndryshohet me tekstin” 2,000 (dymijë) euro deri në 10,000 (dhjetëmijë) euro.”

Amendamenti 43, dy Propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 2.12., paragrafi 12 i nenit 21 i shtuar i ligjit bazik, fshihet.

B) Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 21, paragrafi 12, të riformulohet si vijon:

12. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave bëhen përfundimtare dhe të ekzekutueshme pas përfundimit të afatit prej 5 (pesë) ditësh për apelim.

Amendamenti 44 , dy propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 3.2., paragrafi 11.1. i riformuluar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1 KQZ-ja themelon Zyrën për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, i rekomando KQZ-së certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe kontrollimin e raporteve financiare të subjekteve politike. Zyra e ka përgjegjësinë për hetimin e shkeljeve të Ligjit, dhe i rekomandon KQZ-së për shqiptimin e gjobave.

A) Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3, paragrafi 2, nënparagrafi 11.1 për plotësimin e Ligjit për Zgjedhje të riformulohet si vijon:

11.1 Pranë KQZ-zë themelohet Zyra për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike. Zyra përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatave të Themelore. Zyra emëron drejtorin ekzekutiv që është përgjegjës për funksionimin dhe menaxhimin e Zyrës. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet me konkurs. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në

fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar të këtij ligji, si dhe monitorimin dhe kontrollimin e financave të subjekteve politike. Zyra e ka përgjegjësinë për hetimin e shkeljeve të Ligjit kur bëhet fjalë për financimin, që t'i raportojnë ato pranë autoriteteve kompetente, kur kërkohet, dhe të shqiptojë gjoba. Organizimin e brendshëm e përcakton Zyra përmes Rregullores së Brendshme.

Amendamenti 45

Neni 3.2., në paragrafin 11.1.A. të shtuar të ligjit bazik, në rreshtin e tretë, fjalët “Kryesuesi i KQZ-së do të sigurojë”, zëvendësohen me fjalën “KQZ-së siguron”.

Amendamenti 46

Neni 3.2., paragrafi 11.1.B. i shtuar ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

11.1/B Zyra është nënprogrami i veçantë brenda buxhetit të KQZ-së. Zyrës i ndahet buxhet i mjaftueshëm për shpenzime të rregullta dhe operacionale lidhur me kompensimin e personelit.

Amendamenti 47

Neni 3.2., paragrafi 11.1.C. i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1.C. Përgjashtimisht nga neni 11.1.B. i këtij ligji, KQZ-së i ndahet çdo vit buxhet shtesë për auditimin e financimit të partive politike.

Amendamenti 48

Neni 3.2., paragrafi 11.1.D. i shtuar i ligjit bazik, fshihet në tërësi.

Amendamenti 49

Neni 3.2, paragrafi 11.1.E. i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1.E. Struktura organizative e Zyrës përcaktohet me Rregulloren e Sistematizimit të Vendeve të Punës të miratuar nga KQZ-ja, duke siguruar që Zyra të pajiset me burimet e nevojshme njerëzore për kryerjen e kompetencave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Personeli i Zyrës përbëhet nga punonjës profesionalë, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të një subjekti politik, nuk i kanë dhuruar një subjekti politik dhe nuk kanë qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me një subjekt politik tre vjet para paraqitjes së aplikimit të tyre. Rekrutimi i personelit të Zyrës bëhet në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore të KQZ-së.

Amendamenti 50

Neni 3.2., në paragrafin 11.1.G. të shtuar të ligjit bazik, në rreshtin e shtatë, fjala “Zyra”, zëvendësohet me shkurtesën “KQZ-ja”. Po ashtu në rreshtin e nëntë, fjala “Zyrës”, zëvendësohet me shkurtesën “KQZ-së”.

Amendamenti 51

Neni 3.2., paragrafi 11.1.H. i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1.H. Zyra mund të iniciojë një verifikim të pajtueshmërisë për shkeljet e dëshmime nën betim të auditorëve për mungesën e konfliktit të interesit ose lidhjeve me një subjekt politik, në bazë të ankesave të parashtruara, informacionit të dhënë nga një institucion publik ose me vendim të Drejtorit të Zyrës. Zyra mund të kërkojë informata nga institucionet publike dhe private dhe të ftojë dëshmitarë. Lëndët për shkeljet e dëshmisë nën betim përfundohen brenda 6 (gjashtë) muajsh, me mundësi për 2 (dy) muaj shtesë bazuar në arsyetimin e dhënë me vendim të nxjerrë nga drejtori. KQZ nxjerr dhe publikon në ueb- faqen e saj një vendim nëse një auditor ka shkelur dëshminë e vet nën betim brenda 5 (pesë) ditësh nga përfundimi i lëndës. Në rastet kur është nxjerrë një vendim se një auditor ka shkelur kushtet e dëshmisë së vet nën betim, auditori do të hiqet dhe të gjitha gjetjet e auditorit do të anulohen.

Amendamenti 52

Neni 3.2., në paragrafin 11.1.I. të shtuar të ligjit bazik, në fillim të fjalisë, teksti “Zyra mund të bëjë verifikimin të pajtueshmërisë” zëvendësohet me tekstin “Zyra mund t’i rekomandojë KQZ-së që të bëjë verifikim të pajtueshmërisë”

Amendamenti 53, deputetit Lutfi Zharku, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet dhe shtohen paragrafët 11.11/I (neni 3, paragrafi 2 i projektligjit) të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.1/I Fshihen fjalët “anonime apo ankesave të tjera”

Amendamenti 54

Neni 3.2., në paragrafin 11.1/K të shtuar të ligjit bazik, fshihet fjala “rastësisht”

Amendamenti 55, deputetit Lutfi Zharku, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 003/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet dhe shtohen paragrafët 11.11/K (neni 3 paragrafi 2 i projektligjit) të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.1/K Fshihen fjalët “dhe të thërrasë dëshmitarë për të dhënë dëshmi”.

Amendamenti 56, dy propozime:

A). Komisioni FunkSIONAL

Neni 3.2., paragrafi 11.1/L i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.1/L. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë, KQZ-së i dorëzohet një raport përfundimtar për të gjitha faktet dhe dëshmitë e grumbulluara, me një rekomandim përfundimtar, bazuar në të cilin KQZ-ja nxjerr vendimin nëse subjekti politik e ka shkelur Ligjin, si dhe t'ia shqiptojë gjobën partisë politike dhe zyrtarit të saj financiar dhe/ose drejtuesit të subjektit politik. Vendimi duhet të përfshijë një përshkrim të shkeljes, datën e veprës dhe gjobën e vendosur.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3, paragrafi 2, nënparagrafi 11.1/L të riformulohet si vijon:

11.1/L Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë, Drejtorit i dorëzohet një raport përfundimtar për të gjitha faktet dhe dëshmitë e grumbulluara. Drejtori përgatitë një rekomandim përfundimtar, bazuar në të cilin Paneli mund ta nxjerrë vendimin nëse subjekti politik e ka shkelur Ligjin, si dhe t'ia shqiptojë gjobën partisë politike dhe zyrtarit të saj financiar dhe/ose drejtuesit të subjektit politik. Vendimi duhet të përfshijë një përshkrim të shkeljes, datën e veprës dhe gjobën e vendosur.

Amendamenti 57

Neni 3.2., në paragrafin 11.1/O të shtuar të ligjit bazik, fshihet fjala “respektivisht”.

Amendamenti 58, dy propozime:

A). Komisionit FunkSIONAL

Neni 3.3., paragrafi 11.2 i riformuluar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

11.2. Drejtori i Zyrës emërohet nga KQZ-ja, pas konkursit publik për vend të lirë. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Zyrës bëhet sipas legjislacionit të aplikueshëm për emërimë në pozita të larta drejtuese. Drejtori i Zyrës i raporton drejtpërdrejt KQZ-së.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3, paragrafi 3, nën-paragrafi 11.2 i projektligjit për plotësimin e Ligjit për Zgjedhje të riformulohet si vijon:

11.2 Drejtori i Zyrës emërohet nga Paneli i Zyrës, pas konkursit publik për vend të lirë. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Zyrës bëhet sipas legjislacionit të aplikueshëm për emërim në pozita të larta drejtuese. Paneli i rekrutimit vendosë për emërim të Drejtorit të Zyrës me shumicë të votave. Procedura për përzgjedhjen e drejtorit të Zyrës përcaktohet në detaje me anë të aktit nënligjor të miratuar nga Paneli, duke i pasqyruar kështu parimet e shërbimit civil. Drejtori i Zyrës i raporton drejtpërdrejt Panelit të Zyrës. Paneli i zyrës i përgatitë një raport vjetor të punës KQZ-së.

Amendamenti 59

Neni 3.3., në paragrafin 11.2/A të shtuar të ligjit bazik, fshihet fjala “cili”.

Amendamenti 60

Neni 3.3., në paragrafin 11.2./B, nën-paragrafi 1.4. i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

1.4. Zyra Kombëtare e Auditimit.

Amendamenti 61, dy propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 3.3, teksti pas paragrafit 11.2.B të shtuar të ligjit bazik, bëhet paragrafi 11.2/C. (Në vazhdim bëhet rirenditja e paragrafëve)

B) Deputeti Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 003/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet paragrafi 11.2 dhe shtohen paragrafët 11.2/B (neni 3, paragrafi 3 i projektligjit), të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.2/B Fshihen fjalët “Procedura për përzgjedhjen e drejtorit të Zyrës përcaktohet në detaje me anë të aktit nënligjor të miratuar nga KQZ-ja, duke i pasqyruar kështu parimet e shërbimit civil.”

Amendamenti 62, dy propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 3.3., paragrafi 11.2.C, nënparagrafi 1.2. i shtuar i ligji bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

1.2. të ketë diplomë në njërën nga fushat: të ekonomisë, drejtësisë, shkencave politike, administratë publike.

B). Deputeti Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 003/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet paragrafi 11.2 dhe shtohen paragrafët 11.2/C (neni 3, paragrafi 3 i projektligjit), të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.2/C nënparagrafi 1.2 të zëvendësohen fjalët “në shkencat shoqërore” me “universitare”.

Amendamenti 63, dy propozime:

A) Komisioni FunkSIONAL

Neni 3.3., paragrafi 11.2/D i shtuar i ligjit bazik, fshihet.

B). Deputeti Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 003/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet paragrafi 11.2 dhe shtohen paragrafët 11.2/D (neni 3, paragrafi 3 i projektligjit), të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.2/D Fshihen fjalët “Kryesuesi i KQZ-se mund të nxjerrë një vendim për alokimin e shtesës për rrezikshmëri për Drejtorin e Zyrës.”

Amendamenti 64, dy propozime:

A) Komisionit FunkSIONAL

Neni 3.3., paragrafi 11.2/E i shtuar i ligjit bazik, ndryshohet me tekstin:

11.2.E. Mandati i drejtorit është 5 (pesë) vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Mandati i drejtorit përfundon me:

- 1.1. skadimin e mandatit;
- 1.2. dënimin për veprë penale me aktgjykim të formës së prerë;
- 1.3. shkarkimin, si pasojë e vlerësimit të performancës së dobët për dy vite të njëpasnjëshme;
- 1.4. dorëheqje;
- 1.5. vdekje.

B). Deputetet Albulena Haxhiu dhe Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 3, paragrafi 3, nën paragrafi 11.2.E, të riformulohet si vijon:

11.2.E Mandati i drejtorit është 5 (pesë) vjet me mundësi të riemërimit edhe 1 (një) herë. Mandati i drejtorit mund të përfundojë me:

1.1 skadimin e mandatit;

1.2 dënimin për vepër penale;

1.3 shkarkimin, si pasojë e performancës së dobët, të përcaktuar nga Paneli i Zyrës;

1.4 dorëheqje;

1.5 vdekje.

Amendamenti 65, dy propozime:

A) Komisionit FunkSIONAL

Neni 3.3., Paragrafi 11.2/F i shtuar i ligjit bazik, fshihet.

B). Deputeti Lutfi Zharku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 11 i Ligjit nr. 003/L-073 për zgjedhje të përgjithshme riformulohet paragrafi 11.2 dhe shtohen paragrafët 11.2/F (neni 3, paragrafi 3 i projektligjit), të ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

11.2/F Fjala “qëllimisht” zëvendësohet “me apo pa qëllim” dhe fshihen fjalët “dhe ndalohet nga punësimi dhe shërbimi publik për një periudhë prej se paku 3 (tre) vitesh”

Amendamenti 66

Neni 3.4., paragrafi 11.6, pika a e shtuar e ligjit bazik, riformulohet me tekstin si vijon:

- a. Të botojë dhe mbajë të botuar në ueb faqen e KQZ-së raportin tremujor financiar dhe raportin financiar të fushatës së subjekteve politike.

Neni 3.4., paragrafi 11.6, në pikën b të shtuar të ligjit bazik, fjalët “e saj zyrtare”, zëvendësohet me fjalët “e KQZ-së”.

Amendamenti 67

Neni 3, fshihen paragrafët 6, 7, 8 dhe 9.

Në paragrafin 11 të nenit 3, fjala “shfuqizohet”, zëvendësohet me fjalën “fshihet”.

Amendamenti 68

Neni 3.12, neni 42 i ndryshuar i ligjit bazik, me tekstin si vijon:

Neni 42

Sanksionet

42.1. KQZ-ja në pajtim me legjislacionin në fuqi, iu shqipton gjoba subjekteve politike që paraqesin Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës pas afatit të zbatueshëm. KQZ-ja çdo gjobë që mbledh sipas këtij ligji e derdh në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

42.2. Vendosja e një gjobe ose sanksioni tjetër nga KQZ-ja nuk paragjykon ndonjë sanksion penal që mund të zbatohet.

42.3. Subjekti politik mund të apelojë vendimin e KQZ-së për vendosjen e gjobës pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas pranimit të vendimit nga KQZ-ja.

42.4. Subjektet politike duhet t'i paraqesin KQZ-së një kopje të fletëpagesës së gjobës të paguar.

Amendamenti 69

Neni 3, paragrafi 15 fshihet.

Amendamenti 70

Neni 3, paragrafi 16, teksti referues “Neni 126, paragrafin 126.1 fshihet, ndërsa paragrafi 126.2 ndryshohet si vijon:

ndryshohet, me tekstin referues si vijon:

“16. neni 126, paragrafi 126.2 ndryshohet me tekstin si vijon:

Amendamenti 71

Neni 4, fshihet.

Amendamenti 72

Neni 5, riformulohet me tekstin si vijon:

Neni 5

Dispozitat kalimtare

Zyra trashëgon personelin ekzistues, arkivin dhe asetet e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike.

Amendamenti 73, deputeti Dardan Molliqaj – Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Nenit 6 të projektligjit i shtohet një paragraf dhe i ndryshohet emërtimi, si vijon:

Neni 6 Zbatimi dhe hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji zbatohet ndarja e fondeve për financimin e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për vitin buxhetor në të cilin ka hyrë në fuqi ky ligj. Në asnjë mënyrë shpërndarja e fondeve sipas ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 03/L174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, sipas nenit 2, paragrafit 6 të këtij ligji nuk do të ndërlihet me skadimin e mandatin aktual. Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen për grupet parlamentare të cilat janë të deklaruar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

I. Arsyetimin lidhur me këtë raport e paraqet deputeti Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit.

**Kryetari Komisionit,
Lumir Abdixhiku**